



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.70/2022

GJYKATA KOMERCIALE – DHOMA E SHKALLËS SË DYTË, e përbërë nga gjyqtari individual Faton Bajrami, në çështjen përmbareme të kreditorit Kompania e Sigurimeve “S...” me seli në Prishtinë, ndaj debitorit Komuna e Lipjanit, me bazë juridike përmbushjen e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega ne Lipjan, PPP.nr.16/19, të datës 21.05.2020, me datë **01.09.2022**, mori këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet si e themeltë ankesa e debitorit Komuna e Lipjanit, ndërsa **anulohet** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega ne Lipjan, PPP.nr.16/19, të datës 21.05.2020,dhe çështja i kthehet në procedim të serishëm, Gjykatës Komerciale, Dhomës se Shkallës së Parë.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë- Dega ne Lipjan, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.16/19, të datës 21.05.2020, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Lipjanit dhe e ka lënë në fuqi urdhrin përmbareme, P.nr.4085/2018, të datës 28.12.2018, të lëshuar nga zyra përmbareme e përmbaremit privat Flamur Bogaj, në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i debitorit, për shkak të shkeljes së dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbareme, shkeljes së ligjit material dhe per shkak te vërtetimit te gabuar te gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkalles se

dyte, të aprovojë si të bazuar ankesën e debitorit dhe aktvendimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë ta anulojë dhe çështjen ta kthejë në rivendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, aktvendimit të ankimuar dhe pretendimeve ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa është e themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania e Sigurimeve “S...” me seli në Prishtinë, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Komuna e Lipjanit, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturave me numër 0006412947, 0006425721, 0006335696, 0006304077, 000629760, 0006220469, 0006418412 dhe 0006169651 në vlerë prej 2,909.98 Euro. Përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin me urdhrin P.nr.4085/18, të datës 28.12.2018, ndaj të cilit urdhër debitorit ka ushtruar prapësim. Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimit dhe përgjigjes në prapësim ka vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së dyte, vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta pranojë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje procedurale dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183, paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës përmbartimore në kuptim të nenit 29 Ligjit për Procedurën Përmbartimore dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183, paragrafi 1 të LPK-së, kur ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, duke e lënë në fuqi urdhrin për përmbartim P.nr.4085/18 të datës 28.12.2018. Gjykata, në rastin konkret nuk e ka vlerësuar në mënyrë të drejtë faturat e prezantuar e të bashkëngjitura në propozimi për përmbartim, pasi që disa prej tyre janë të panënshkruara nga asnjëra pale, e po ashtu nga shikimi në punën juridike, mbi bazën e se cilës kanë derivuar faturat (Kontrata Publike Kornize, me titull: Sigurimi i Automjeteve nga Auto përgjegjësia ndaj palëve të treta) rezulton se në mënyrë shprehimore ka qene e përcaktuar lënda e kontratës, përkatësisht numri dhe lloji i automjeteve për të cilat është kontraktuar sigurimi i detyrueshëm, e po ashtu me kontrate palët e kanë parapare se faturat duhet të i dorëzohet zyrës së prokurorit, derisa nga shikimi në fatura gjykata nuk ka vërtetuar një fakte të tilla. Gjykata e shkallës së parë, për shkak të paqartësive lidhur me këto fatura është dashur që konform nenit 73 të LPP-së, të hap seancë dëgjimore për të kuptuar validitetin e prapësimit dhe kështu të vërtetojë në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike. Andaj, nga të cekurat më lartë,

aktvendimi i ankimuar duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në procedim të serishëm në gjykatën e shkallës së parë.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh vërejtjet e cituara më lartë, të vlerëson në mënyrë të drejtë dokumentin e besueshëm nëse faturat sipas dispozitave të LPP-së, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm, e pas kësaj të vazhdojë procedurën konform dispozitave ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE – DHOMA E SHKALLËS SË DYTË
Kom.Dh.Shk.II.nr.70/2022, me datë 01.09.2022

Gjyqtari,
Faton Bajrami